

# **NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA**

## **FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

Për: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Kevin Konstruktion” shpk NUIS K71401004W me adresë: Rruga Adem Jashari”, Nderresa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane & “Company Riviera” 2008 NUIS K81716011V& & “Mela”shpk NUIS K62320011G & “Pepa Group”shpk” NUIS L42215009L.

Procedura e prokurimit: Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-56909-04-27-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës /marreveshjes kuader:“Rindërtimi i banesave individuale, ndërtimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave.”

Fondi limit i minikonkursit: 2,047,592,928 Leke Pa TVSH.

Objekti i minikonkursit: “Rindërtimin e 743 banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të tyre”, nga të cilat 127 banesa sipas modelit 1+1, 277 banesa sipas modelit 1+2 dhe 339 banesa sipas modelit 1+3“.

Kohëzgjatja e kontratës 150 dite kalendarike.

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar palë në marrëveshje kuadër:

1. Operatori Ekonomik “2 T” sh.p.k., NUIS K01731001M.
2. Operatori Ekonomik “Agi Kons” sh.p.k NUIS K21622001M.
3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Boshnjaku. B” sh.p.k., NUIS K72627402H & “Llazo” sh.p.k., NUIS K24218401K.
4. Operatori Ekonomik “Gjikuria” sh.p.k NUIS J62903456H.
5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “G.P.G. Company” sh.p., NUIS J64324443V & “Shendelli” sh.p.k., NUIS K07924803N.
6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “KAPLAN CAM ALUMINYUM OTOI\IOTIV SANAYI TICARET” & “PREFABRIK YAPI INS.SAN.VE.Ti.AS” & BEGEN MUHENDISLIK INS. TAAH. SN. VE TIC.LTD.STI.”
7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk NUIS K71401004W &“Company Riviera” 2008 NUIS K81716011V& & “Mela”shpk NUIS K62320011G & “Pepa Group”shpk” NUIS L42215009L.
8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Senka” sh.p.k., NUIS J94808405Q & “Dajti Park 2007” sh.p.k., NUIS K11507003S & & “Erzeni/SH ” shpk NUIS J66902027T.
9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Shijaku” shpk NUIS J64102272V & “CO1 Rroku Konstruktion Tiranë” NUIS K41517031, & “Älfons Shtjefni” person fizik NUIS L52324030J.

10. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “The Best Construction” shpk NUIS K41510019W & “Vëllezërit Hysa” NUIS K12911201C & “Arifaj”shpk NUIS J76418907K & “Denis-05”shpk” NUIS K51518029B.
11. Operatorit Ekonomik “Alb-Building” sh.p.k NUIS J69102508C.
12. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ALKO-IMPEX General Construcion”sh.p.k NUIS K91326028I & “Sireta 2F” sh.p.k., NUIS K51501008J & “IBN” sh.p.k., NUIS L21309010H.
13. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Aurora Konstruksion” sh.p.k., NUIS K02017003I & “Eren İnşaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Şirketi” sh.p.k., NIT 3530060833 & “Rafaelo 2002” sh.p.k., NUIS K22113003Q.
14. Operatori Ekonomik “GENER 2” sh.p.k NUIS K58615301M.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazen tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Nr	Operatorët Ekonomikë	Oferta ekonomike lekë / pa TVSH	Pikët Total
1	BOE “Kevin Konstruksion” shpk & “Company Riviera” 2008 & “Mela”shpk & “Pepa Group”shpk”	2,004,560,000.00	98.32
2	BOE “KAPLAN CAM ALUMINYUM OTOI\,IOTIV SANAYI TICARET” & “PREFABRIK YAPI INS.SAN.VE.Ti.AS” & BESGEN MUHENDISLIK INS. TAAH. SN. VE TIC.LTD.STI.”	2,040,523,860.00	97.29
3	BOE “G.P.G. Company” sh.p.k. & “Shendelli” sh.p.k.	1,948,500,000.00	95.00
4	BOE “Boshnjaku. B” sh.p.k. & “Llazo” sh.p.k.	2,021,647,887.00	92.42
5	BOE “The Best Konstruksion” & “Vëllezërit Hysa” & “Arifaj”shpk & “Denis- 05”shpk”	2,047,148,000.00	91.70
6	BOE “Shijaku” shpk & “CO1 Rroku Konstruksion Tiranë” shpk	2,226,918,100.00	87.09
7	OE “Alb-Building” sh.p.k	2,763,343,580.00	76.90

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm: Perkatësisht për arsyet e mëposhtme.

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë (BOE) “KAPLAN CAM ALUMINYUM OTOI\,IOTIV SANAYI TICARET” & “PREFABRIK YAPI INS.SAN.VE.Ti.AS” & BESGEN MUHENDISLIK INS. TAAH. SN. VE TIC.LTD.STI.

Referuar ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, rezulton se oferta për këtë minikonkurs është paraqitur nga vetëm anëtarë të bashkimit të operatorëve, konkretisht subjekti “PREFABRIK YAPI INS.SAN.VE.Ti.AS dhe subjekti “BESGEN MUHENDISLIK INS. TAAH.

SN. VE TIC.LTD.STI”, ndërkohë që ky bashkim (BOE) palë në marrëveshjen kuadër të lidhur me autoritetin kontraktor, ka në përbërje edhe subjektin “KAPLAN CAM ALUMINYUM OTOMOTIV SANAYI TICARET”. Duke qenë se ky i fundit nuk e ka shprehur vullnetin në emrin e tij nga përfaqësuesi ligjor apo nga çdo person të autorizuar prej tij konsiderohet se oferta për këtë minikonkurs nuk është paraqitur nga bashkimi i operatorëve pjesë e marrëveshjes kuadër, dhe për këtë arsye kjo ofertë për këtë minikonkurs nuk mund të pranohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Kevin Konstruksion” shpk NUIS K71401004W me adresë: Rruga “Adem Jashari”, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane & “Company Riviera” 2008 NUIS K81716011V& & “Mela”shpk NUIS K62320011G & “Pepa Group”shpk” NUIS L42215009L, se oferta e paraqitur nga ana juaj në vlerën 2,004,560,000.00 lekë pa tvsh dhe e vlerësuar me 98.32 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10, Tirana, Albania, Phone: 00355 42 235 597/8 (int. 151, Fax: 00355 42 234 885, sigurimin e kontratës 15%, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar.

Ankesa: JO